

Rezearta Kokonozi është juriste dhe funksionare e administratës publike me përvojë të gjatë në strukturat qendrore të institucioneve shtetërore. Ajo ushtron aktualisht detyrën e **Drejtoreshës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore** në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Në Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Gjatë karrierës së saj profesionale, znj. Kokonozi ka mbajtur funksione drejtuese në Ministrinë e Kulturës, në pozicionin e **Drejtoreshës së Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve**, si dhe ka ushtruar detyrën e **Drejtoreshës së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve**. Ajo ka shërbyer gjithashtu si **Përgjegjëse Sektori** në Drejtorinë e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, duke kontribuar në hartimin, koordinimin dhe harmonizimin e legjislacionit në fushën e kulturës dhe administrimit publik.

Më herët, znj. Kokonozi ka ushtruar funksionin e **Titullares së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike**, ku ka drejtuar dhe koordinuar veprimtarinë administrative të institucionit, si dhe e ka përfaqësuar atë në marrëdhënie me të tretët. Ajo ka nisur karrierën e saj në administratën publike si **Specialiste Juriste**, duke u angazhuar në hartimin e dokumentacionit ligjor, zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, përfaqësimin në procese gjyqësore dhe pjesëmarrjen në grupe pune për hartimin e legjislacionit.

Znj. Kokonozi është diplomuar në **Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës**, me diplomë të integruar të nivelit të dytë. Ajo ka ndjekur trajnime dhe kualifikime profesionale pranë **Shkollës Shqiptare të Administratës Publike**, si dhe pranë institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë UNESCO-n, në fusha të tilla si Kodi i Procedurave Administrative, hartimi i legjislacionit, prokurimi publik, të drejtat e njeriut dhe zbatimi i konventave ndërkombëtare.

Znj. Kokonozi ka qënë më herët edhe **anëtare e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale** dhe ka kontribuar në grupe pune për hartimin e akteve nënligjore të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si dhe në hartimin e projektligjeve me rëndësi kombëtare.